

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM**Nr.122, datë 17.2.2011**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1124, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PROCEDURAVE DHE KRITEREVE PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E SPECIALISTIT, PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS DHE AUDITIMIN MJEDISOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 31 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.1124, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:
"2. Të drejtën për t'u pajisur me certifikatë e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitetet ose shkollat e larta jopublike, të akredituara për degët e sipërpërmendura ose në institucionet e huaja të arsimit të lartë që ofrojnë këto programe studimi, pas njësimit të diplomës së tyre, si dhe specialistët e diplomuar në shkencat inxhinierike, biologjike, kimike, gjeologjike, hidrologjike, ekonomike dhe gjeografike. Certifikata e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor jepet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave."
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Sali Berisha**Copyright 2012 - www.ligjet.org